# DËSHMI ARKIVI

**A-470993**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Lidhjet - Thellohet skandali i narko-shtetit/ Mediat rumune: Vlora Hyseni u trajnua nga 'Gjenerali i Zi' |
| ADRESA | `https://www.syri.net/kronike/919285/thellohet-skandali-i-narko-shtetit-mediat-rumune-vlora-hyseni-u-trajnua-nga-gjenerali-i-zi/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 09:29:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 08:44:26 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0b617744123b7641dde287406bb4d5ba21e2f07be720f13ea04b83497924cefd` |
| TEKSTI | `ef146164cfb35f1a6e6c28933221163f0011808207e4e5b14a4bf98bb6ce443e` |
| PAMJA | `5a7165fc1215b21878ebaedbb5da89e61361f0c698ef57a9e7f683a96e039f05` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `358d32aafddb92b6bee3571ee34b6ecebc80e5723b172089dce213a97375afea` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `bbc3301522765d1bd7c753c64180377d11d281903b5d3d3b2cb5e4d7203a8042` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/358d32aafddb92b6bee3571ee34b6ecebc80e5723b172089dce213a97375afea`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



ENVER BYTYÇI

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!



# Thellohet skandali i narko-shtetit/ Mediat rumune: Vlora Hyseni u trajnua nga ‘Gjenerali i Zi’

10:44, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A - 

***Ish-këshilltari i jashtëm i Edi Ramës, ish-gjenerali i shërbimit sekret rumun, Florian Coldea, rikthehet në qendër të vëmendjes së medieve rumune pas arrestimit të Vlora Hysenit. Coldea akuzohet nga autoritetet rumune se ka ndihmuar kartelin Sinaloa për të trafikuar kokainë, e cila vinte nga Shqipëria dhe më pas përhapej në Evropë. Por tashmë mediat rumune raportojnë se ‘Gjenerali i zi’ ka trajnuar Vlora Hysenin.***

**REALITATEA**

Sipas shtypit shqiptar, Florian Coldea ndodhet këto ditë në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë. Gjithçka vjen pasi drejtuesja e shërbimeve të inteligjencës së Shqipërisë është pezulluar nga detyra dhe ndaj saj është lëshuar një urdhër arresti.

Mediet nga Tirana bëjnë të ditur se drejtuesja e shërbimeve shqiptare dhe Coldea kanë pasur lidhje të ngushta në kohën kur gjenerali ishte këshilltar i kryeministrit Edi Rama.

Disa burime shkojnë edhe më tej dhe thonë se gruaja mund të jetë trajnuar operacionalisht nga “Gjenerali i Zi”. Realitatea PLUS i ka kërkuar një qëndrim Florian Coldeas, por deri në këtë moment ai nuk është përgjigjur.

Vlora Hyseni akuzohet për zbulimin e sekreteve shtetërore dhe për favorizimin e një të dyshuari për vepra penale, pjesë e rrjeteve të krimit të organizuar. Dosja po hetohet nga SPAK-u, struktura shqiptare e specializuar në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Shtypi shqiptar, i cituar nga Inpolitics, shkruan se Vlora Hyseni ka punuar në një moment së bashku me Florian Coldean, gjatë periudhës kur ky i fundit ishte këshilltar i kryeministrit Edi Rama. Në kohën kur u emëruan në detyrat e tyre, si Florian Coldea, ashtu edhe Vlora Hyseni shkaktuan skandale të vërteta.

Madje, shkruan shtypi shqiptar, të dy madje do të kishin ndarë të njëjtën zyrë për një periudhë. Pasi u bë drejtues i SRI-së, thonë gazetarët, Coldea do të ishte përfshirë edhe në shërbimet shqiptare. Disa burime shkojnë edhe më tej dhe thonë se gruaja do të ishte trajnuar operacionalisht pikërisht nga Florian Coldea.

## më të lexuarat

FOTO/ Shqiptarët arratisen me një BMW X6 të vjedhur, aksidentojnë tre makina dhe plagosin një polic

Zjarret/ Në qarkun Lezhë u dogjën 2500 hektarë pyje dhe 12 banesa

Zjarri në Gjirin e Lalzit vijoi gjatë natës, u evakuuan turistë e banorë

Tentuan të transportonin 6 emigrantë drejt Greqisë, arrestohen dy persona në Sarandë

EMRAT/ Plagosën të riun pas sherrit për riparimin e makinës, shpallen në kërkim babë e bir

Vrasja në Tiranë/ Zbardhet dëshmia e autorit: U zumë me fjalë, e godita disa herë me thikë në bark

Mediat kanë raportuar gjithashtu se Hyseni do të kishte bërë udhëtime dhe takime jashtë Shqipërisë së bashku me Coldean, përfshirë edhe pas marrjes prej saj të drejtimit të Shërbimeve të Shqipërisë.

Ndërkohë, Florian Coldea është dërguar për gjykim në dosjen që lidhet me trafikimin e influencës, krijimin e një grupi të organizuar kriminal dhe pastrimin e parave. Së bashku me të akuzohen edhe Dan Tocaci dhe avokati Doru Trăilă.

Seanca e radhës për ankimin që ndodhet në shqyrtim në Gjykatën e Lartë është planifikuar për 15 tetor 2026.

© SYRI.net

Lexo edhe:


Ndjekje si në filma/ Trafikantët shqiptarë përfundojnë në pranga pasi u shpua goma e makinës


EMRAT/ Arrestohet i 'forti' i Shkodrës, shpallet në kërkim Indrit Dokle


Qarku Kukës nën reshje shiu e bore, gurë e dhera në disa akse rrugore

Rodos/ Shqiptari i merr 15 mijë euro polakes dhe e kërcënon me fotot nudo

Detaje tronditëse/ Ergys Agasi mori të dhënat e telefonave të 'zbërthyer' nga policia

Arrestohen në flagrancë 2 persona, policia u gjen në banesa armë dhe municion luftarak

## TË NGJASHME

Atentati ku u plagos 10-vjeçarja shqiptarja/ Babai i saj ka hesape me një të burgosur të rrezikshëm

Arrestohet në Rinas ukrainasi Anatolii Streletskyi, kërkohej nga autoritetet e Kievit

Rrjeti i Agasit/ Mes tenderëve të AKSHI-t, pengmarrjes së Meçes dhe sekreteve të SHISH

Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi/ Policia publikon masat, ja rrugët që bllokohen nga ora 17:00 në Tiranë

Atentat në Athinë, plagoset një fëmijë shqiptar

Aksident i rëndë në aksin Fushë-Krujë–Krujë, raportohet një viktimë

VIDEO/ Nga tritoli në banesë te përplasjet me eprorët dhe kërcënimet, denoncimet e bujshme të efektivit të FNSH-së



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.